



EPTA
SIGURIA NË PUNË

SHËRBIME PROFESIONALE NË FUSHËN E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË


- **TRAJNIME & CERTIFIKIME**
- **KONSULENCË & SUPERVIZIM**
- **STANDARDET ISO**
- **OFRIM I EKSPERTËVE TË JASHTËM**
- **HARTIM I DOKUMENTACIONIT TË SIGURISË**
- **MJEKU I PUNËS**


 +355 68 905 9505

 +355 69 609 5866

 Info@epta-al.com

 Marketing@epta-al.com

 www.epta-al.com

 "Rruga e Dibrës", Tiranë



PARTNERI JUAJ PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË

Rreth EPTA Sh.p.k

EPTA Sh.p.k është kompani inxhinierike që ofron shërbime të specializuara në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Themeluar nga ekspertë me përvojë mbi 10-vjeçare në këtë fushë, EPTA ofron shërbime në mënyrë efikase dhe profesionale, duke u mbështetur në standardet ndërkombëtare dhe njëkohësisht në legjislacionin shqiptar për sektorin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Me një staf profesional dhe të kualifikuar, EPTA ofron dhe mbulon shërbime për të gjithë sektorët e Sigurisë & Shëndetit në punë në aktivitete të profileve të ndryshme.

Partnerët tanë

Ndër vite EPTA Sh.p.k ka realizuar shërbime të ndryshme për projekte të rëndësishme si: Durrës Yachts & Marina, Vlora International Airport, Green Coast, Tirana Rock, TITAN dhe kompani si: TRING, Forscher, GENER 2, BALFIN Construction dhe shumë kompani të tjera.

Shërbimet kryesore



Trajnime dhe Certifikime në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.



Konsulencë dhe Supervizim në projekte të ndryshme



Hartim dhe Zhvillim i Dokumentacionit të Sigurisë



Standardet ISO



**Ofrimi i Ekspertëve të Jashtëm
OUTSOURCING**



Mbështetur në kuadrin ligjor shqiptar dhe standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe shëndetit në punë EPTA sh.p.k ofron kurse trajnimi për një gamë të gjerë aktivitesh, me programe të miratuara dhe lektorë me eksperiencë.

Ligji Nr. 10237

Ligji Nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", i ndryshuar, i cili përcakton detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit për garantimin e kushteve të sigurta të punës. Gjithashtu ky ligj parashikon hartimin e vlerësimit të rreziqeve, organizimin e shërbimeve të sigurisë në punë dhe trajnimin e punonjësve.

VKM Nr.312

VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për organizimin e shërbimeve të sigurisë dhe shëndetit në punë", vendim i cili përcakton kërkesat minimale për garantimin e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve në kantieret e ndërtimit, organizimin e kantierit, detyrimet e investitorit dhe kontraktorit, caktimin e koordinatorëve të sigurisë në fazë projektimi dhe zbatimi.

VKM Nr.107 & 108

VKM Nr.107 dhe VKM Nr.108, datë 9.2.2011 përkatësisht "Për këshillat e sigurisë dhe shëndetit në punë" dhe "Për aftësitë dhe kualifikimet e specialistëve të SHP". Këto vendime përcaktojnë Krijimin e Këshillit të Sigurisë në Punë në kompani, Përfshirjen e punëdhënësit dhe përfaqësuesve të punonjësve; Kriteret për Trajnimin, kualifikimin dhe certifikimin e personave që do të ofrojnë shërbime në fushën e SSHP, si specialistët e sigurisë në ndërmarrje, konsulentët dhe auditorët e sigurisë.

VKM Nr.564

VKM Nr. 564, datë 3.7.2013 "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës", i cili përcakton standardet bazë për organizimin e ambienteve të punës, duke përfshirë kushtet e brendshme, daljet e emergjencës, masat kundër zjarrit, higjienën dhe mirëmbajtjen e tyre.

VKM Nr.562 & 563

VKM Nr. 562 dhe VKM Nr. 563, datë 3.7.2013 përkatësisht "Përdorimi i pajisjeve të punës", VKM 562 e cila rregullon makineritë & pajisjet e punës dhe përcakton procedurat për mirëmbajtje dhe kontroll të teknike dhe VKM 563 "Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale (PPE)" e cila rregullon përdorimin e helmetave, dorezave, veshjeve mbrojtëse, maskave, këpucëve dhe synon parandalimin e aksidenteve dhe dëmtimeve fizike në punë.

Standardet Ndërkombëtare

Shërbimet që EPTA Sh.p.k ofron lidhen ngushtë me standartet: ISO 45001, ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 39001, standarde të cilat përcaktojnë kërkesat për sistemet e menaxhimit të: shëndetit dhe sigurisë në punë, cilësisë, mjedisit dhe sigurisë rrugore.

TRAJNIME & CERTIFIKIME

NË FUSHËN E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË

EPTA Sh.p.k ofron një gamë trajnimesh profesionale dhe me certifikim në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Për çdo kompani, aktivitete që duhet të trajnojnë punonjësit, disa nga trajnimet kryesore që do të gjeni pranë nesh janë:

PERGJEGJËS I SIGURISË



Trajnimi u drejtohet Përgjegjësve të Sigurisë në kompani publike apo private.



Kohëzgjatja e trajnimit është 40 orë dhe zhvillohet nga lektorë të fushës.

Në përmbajtje të trajnimit

- Kuadri ligjor shqiptar dhe standardet evropiane për sigurinë në punë në kantieret e ndërtimit, industri dhe aktivitete të profileve të ndryshme
- Identifikimi i rreziqeve dhe analizimi i tyre në mjedisin e punës
- Vlerësimi dhe menaxhimi i riskut
- Sistemet e menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë
- Masat parandaluese dhe mbrojtëse
- Organizimi dhe menaxhimi i situatave emergjente.

KOORDINATOR I SIGURISË NË FAZË PROJEKTIMI & ZBATIMI



Trajnimi u drejtohet Koordinatorëve të Sigurisë në Fazën e Zbatimit / Projektimit



Kohëzgjatja e trajnimit është 120 orë dhe zhvillohet nga lektorë të fushës.

Në përmbajtje të trajnimit

Kuadri ligjor shqiptar & evropian për sigurinë në punë në kantieret e ndërtimit;
Identifikimi i rreziqeve;
Dokumenti i Vlerësimit të Risqeve,
Plani i Koordinimit të Sigurisë, Plani Operativ i Sigurisë,
Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë,
Planin e Emergjencave, formatet e dokumentacionit.

PUNIME NË LARTËSI



Trajnimi u drejtohet kompanive që kanë punonjës dhe drejtues, të cilët zhvillojnë ose mbikqyrin aktivitete në lartësi.




Kohëzgjatja e trajnimit është 8-16 orë dhe zhvillohet nga lektorë të fushës.

Në përmbajtje të trajnimit

kuadri ligjor shqiptar & standardet evropiane për sigurinë në punë në kantieret e ndërtimit;
Identifikimi i rreziqeve;
Vlerësimi i risqeve,
Masat Parandaluese & Mbrojtëse,
Pajisjet Mbrojtëse Individuale.



PARANDALIMI & MBROJTJA NGA ZJARRI



Trajnimi u drejtohet Kompanive të cilat duhet të trajnojnë punonjës për menaxhimin e emergjencës së zjarrit.



Kohëzgjatja e trajnimit është 8 orë dhe zhvillohet nga lektorë të fushës.

Në përmbajtje të trajnimit

Ligji shqiptar për mbrojtjen nga zjarri,
Funksionimi i skuadrave të emergjencës,
Mjetet për mbrojtjen nga zjarri,
Evakuimi sipas nivelit të riskut nga zjarri,
Shkaqet kryesore të dhe llojet e zjarreve,
Mbrojtja dhe procedurat e ndjekura në rast zjarri,
Ushtrime praktike për përdorimin e fikseve gjatë simulimit të njëzjarri të kontrolluar.

NDIHMJA E PARË MJEKËSORE



Trajnimi u drejtohet Kompanive të cilat duhet të trajnojnë punonjës për dhënien e ndihmës së parë mjekësore në punë.



Kohëzgjatja e trajnimit është 8 orë dhe zhvillohet nga mjek specialist.

Në përmbajtje të trajnimit

Njohja e urgjencave mjekësore,
Vlerësimi i gjendjes së të lënduarit,
Njohuri themelore mbi: anatominë dhe fiziologjinë e sistemeve kardiovaskulare dhe respiratore,
Traumat në vendin e punës,
Zbatimi i masave të ndihmës së parë: frymëmarrje artificiale, masazh i jashtëm kardial CPR
Përdorimi i AED dhe kombinimi me procedurën e CPR,
Ndihma e parë në raste: frakturash, djegie etj.

PAJISJE MBROJTËSE INDIVIDUALE PMI



Trajnimi u drejtohet Kompanive, punonjësit e të cilave zhvillojnë aktivitete që përmbajnë risk në vendin e punës.



Kohëzgjatja e trajnimit është 8 orë dhe zhvillohet nga ekspertë të fushës.

Në përmbajtje të trajnimit

Njohuri për detyrimet ligjore,
Njohuri mbi PMI-të e kategorive të ndryshme dhe klasifikimi i tyre,
Kriteret e përzgjedhjes së PMI,
Deklarata e Konformitetit,
Certifikata e kontrollit CE,
Standardi UNI i referimit,
Kuptimi i simboleve/ngjyrave të PMI,
Përdorimi në mënyrë korrekte i pajisjeve.

STANDARDE NDËRKOMBËTARE DHE CERTIFIKIME ISO

Shërbimet që EPTA Sh.p.k ofron lidhen ngushtë me standartet: ISO 45001, ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 39001, standarde të cilat përcaktojnë kërkesat për sistemet e menaxhimit të: shëndetit dhe sigurisë në punë, cilësisë, mjedisit dhe sigurisë rrugore. Përmes përgatitjes dhe planifikimit, implementimit të këtyre sistemeve dhe certifikimit mbi standartet e mësipërme.

Standarti ISO 45001:2018

- Hartimin e politikave të shëndetit dhe sigurisë në punë,
- Identifikimin e rreziqeve dhe vlerësimin e riskut,
- Vendosjen e masave parandaluese dhe kontrolluese,
- Trajnimin e stafit për sigurinë në punë,
- Monitorimin e performancës dhe përmirësimin e vazhdueshëm,
- Përgatitjen për auditim dhe certifikimi ISO 45001:2018.

Standarti ISO 9001:2015

- Zhvillimin e dokumentacionit të sistemit të cilësisë,
- Organizimin dhe strukturimin e proceseve të punës,
- Vendosjen dhe ndjekjen e objektivave të cilësisë,
- Kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së produkteve/shërbimeve,
- Identifikimin dhe menaxhimin e risqeve dhe mundësive,
- Përgatitjen për auditim dhe certifikimi ISO 9001:2015.

Standarti ISO 14001:2015

- Identifikimin e aspekteve dhe ndikimeve mjedisore,
- Hartimin e politikave dhe objektivave mjedisore,
- Zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit,
- Menaxhimin e mbetjeve dhe burimeve natyrore,
- Sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin mjedisor,
- Përgatitjen për auditim dhe certifikimi ISO:14001:2015.

Standarti ISO 39001:2012

- Analizimin e rreziqeve që lidhen me trafikun dhe transportin,
- Hartimin e politikave dhe procedurave për sigurinë rrugore,
- Vendosjen e masave për parandalimin e aksidenteve,
- Trajnimin e stafit dhe drejtuesve të mjeteve,
- Monitorimin e performancës së sigurisë rrugore,
- Përgatitjen për auditim dhe certifikimi ISO 39001:2012.

KONSULENCË & SUPERVIZIM

Shërbimi i Konsulencës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë ofron një paketë të plotë shërbimesh profesionale për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit të punonjësve në vendin e punës.

Konsulenca përfshin inspektimin periodik të aktiviteteve të punës, vlerësimin e rreziqeve, kontrollin e dokumentacionit ligjor dhe të paisjeve mbrojtëse, si dhe orientimin e stafit për masat parandaluese dhe procedurat e emergjencës.

Shërbimi i konsulencës realizohet përmes konsulentit të sigurisë, i cili siguron asistencë të vazhdueshme për menaxhimin e rreziqeve, koordinimin e aktiviteteve të sigurisë, si dhe mbledhjet e rregullta dhe jashtëzakonshme të këshillit të sigurisë për të gjithë punonjësit dhe sipas projektit/kompanisë, nënkontraktorët.

Konsulenti gjithashtu siguron dokumentacionin bazë të kantierit, magazinës apo ambientit ku zhvillohet aktiviteti i kompanive, përfshirë planin e masave korrigjuese, planin e evakuimit, planin e emergjencës, regjistrin e aksidenteve dhe skedat e ambienteve dhe pozicioneve të punës, duke garantuar përputhshmërinë me legjislacionin shqiptar.



Shërbimi përfshin gjithashtu konsulencë ligjore të sigurisë dhe shëndetit në punë për kompaninë, duke mbështetur përgatitjen dhe plotësimin e dokumentacioneve të kërkuara gjatë inspektimeve nga institucionet shtetërore dhe ndjekjen e procedurave ligjore.

Gjithashtu, në shërbimi i konsulencës përfshin formimin profesional dhe certifikimin e stafit sipas legjislacionit në fuqi, për trajnimet mbi përdorimin e paisjeve mbrojtëse, parandalimin e zjarrit, ndihmën e parë dhe menaxhimin e emergjencave.

Përveç trajnimeve, konsulenti organizon shërbimin shëndetësor të punonjësve përmes Mjekut të Punës, duke kryer vizita të rregullta shëndetësore, hartimin e kartelave shëndetësore dhe raportimin për gjendjen e punonjësve, si dhe ofron këshillim për përmirësimin e kushteve të punës dhe higjienës. Konsulenca siguron një menaxhim të plotë dhe profesional të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo kompani.



OFRIMI I EKSPERTËVE TË JASHTËM

EPTA sh.p.k ka në përbërjen e saj një grup të specializuar ekspertësh në Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (HSE), të cilët ofrojnë shërbime të avancuara dhe ekspertizë profesionale për kompani dhe institucione të ndryshme, duke siguruar që aktivitetet e tyre të jenë në përputhje me ligjet dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për HSE.

Figurat kryesore profesionale që EPTA sh.p.k ofron për kompanitë janë:

Përgjegjës HSE

Ky profesionist merr përsipër menaxhimin e plotë të HSE në një kompani, duke zhvilluar politika dhe procedura, monitoruar rreziqet, kryer trajnime për stafin dhe siguruar përputhshmërinë me ligjet e punës dhe sigurisë. Ai siguron që të gjitha aktivitetet e kompanisë të jenë të sigurta për punonjësit dhe të zvogëlojnë riskun e aksidenteve ose dëmtimeve.

Koordinator i Sigurisë në Fazën e Zbatimit të Projekteve të Ndërtimit

Ky ekspert vepron duke monitoruar dhe koordinuar të gjitha masat e sigurisë gjatë fazës së ndërtimit. Ai identifikon rreziqet, vendos protokolle sigurie dhe bashkëpunon me menaxherët e projektit për të garantuar një ambient pune të sigurt për të gjithë punonjësit në kantier.

Asistencë në Përpunimin e të Dhënave të HSE

Shërbimi përfshin mbledhjen, analizimin dhe përpunimin e të dhënave që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë. Këto të dhëna përdoren për raportime të brendshme, përmirësimin e procedurave të sigurisë dhe për të marrë vendime të bazuara në informacion.

Mjeku i Kompanisë / Institucionit

Mjeku i kompanisë ofron kujdes mjekësor dhe shëndetësor për punonjësit, kryen kontrole periodike, menaxhon rastet e emergjencës dhe asiston në zhvillimin e programeve për mirëqenien dhe shëndetin e stafit. Ai është një figurë kyçe për parandalimin e sëmundjeve profesionale dhe për ruajtjen e një ambienti pune të shëndetshëm.



HARTIMI & ZHVILLIMI I DOKUMENTACIONIT TË SIGURISË

Dokumenti i Vlerësimit të Riskut (DVR) është baza e sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo kompani apo institucion. Është ndër kërkesat e rëndësishme nga aspekti ligjor dhe shërben si udhërrëfyes për menaxhimin e sigurisë në ambientet e punës.

Filozofia:

Parandalimi është parimi udhëheqës i procesit të vlerësimit të riskut. DVR-ja është një "road-map" për menaxhimin e sigurisë, ku punëdhënësit dhe punëmarrësit luajnë rol aktiv. Dokumenti përditësohet rregullisht dhe synon identifikimin e rreziqeve potenciale, përcaktimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse për një mjedis pune sa më të sigurtë.

Metodologjia:

- Bazuar në standardin ISO 45001 dhe ligjin nr. 10237/2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë".
- Analizë e rreziqeve sipas probabilitetit dhe ashpërsisë së pasojave.
- Hartim i skedave identifikuese të vendeve dhe pozicioneve të punës (ViP, PiP).
- Përfshirja e historikut të aksidenteve, kategorive të punëmarrësve të veçantë dhe menaxhimit të punëve nga ndërmarrjet e treta.

Procesi:

- Inspektimi i të gjitha ambienteve dhe pozicioneve të punës.
- Pjesëmarrja aktive e punëmarrësve në identifikimin e rreziqeve dhe vlerësimin e riskut.
- Vlerësimi i faktorëve fizikë, kimikë, biologjikë, ergonomikë dhe psikologjikë.
- Përcaktimi i masave parandaluese, mbrojtëse dhe korrigjuese për të minimizuar ose eliminuar rreziqet.

Rezultati:

Një DVR i plotë, i strukturuar dhe praktik, që garanton:

- Mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm.
- Rritjen e ndërgjegjësimit dhe aftësisë së punëmarrësve për menaxhimin e rreziqeve.
- Përputhshmëri me detyrimet ligjore dhe standardet ndërkombëtare.

PROJEKTE AKTUALE

EPTA është duke realizuar shëndetin dhe sigurinë në disa projekte të rëndësishme në vend siç janë: Durrës Yachts & Marina, Vlora International Airport, Tirana's Rock ...

Durrës Yachts & Marina



Vlora International Airport



Tirana's Rock





”

***Partneri juaj për shëndetin
dhe sigurinë në punë***

”



+355 68 905 9505

+355 69 609 5866



Info@epta-al.com



www.epta-al.com



Rruga e Dibrës, Tiranë

